

mion dhe i çuan në drejtim të Pejës/Peç. Në **Gorazhdëc/Gorazhdëvac**, në udhëkryqin që çon drejt fshatit Loxhë/Loda, Bashkimin, Nimonin dhe Hakiun i zbritën nga kamioni, ndërkaq të burgosurit të tjerë i çuan në burgun e Pejës/Peç. Familjarët kanë mësuar nga mediat e huaja se Nimonin, Hakiun dhe Bashkimin i kishin vrarë, por deri më 27.09.1999, nuk dinin se ku gjendeshin trupat e të vrarëve. Atë ditë, pjesëtarët e UÇK-së u kanë lajmëruar familjarëve se i kanë gjetur varret e tyre në varrezat e Pejës/Peç. Po atë ditë, ushtarët e UÇK-së i kanë rivarrosur mbetjet e tyre mortore në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Gllëgjani/Glodane [Deçan/Deçani].

Burimet: deklarata Xh.M, FDH-35415; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; *Fate of Ten Albanians, Abducted by Serbs, Unknown*, pasqyra e lajmeve, KIC, 6.08.1998, FDH-29402.

Tahir (Sali) Shala

(15.03.1965, shqiptar nga Loxha/Loda, komuna e Pejës/Peç, bujk, tre fëmijë)

Në datën **6.07.1998**, forcat policore serbe e kanë kryer sulmin ndaj forcave të UÇK-së në fshatin **Loxhë/Loda**. Kur dëgjoi se forcat serbe po afroreshin nga drejtimi i fshatit Graboc/Grabovac, Tahiri e rroku pushkën dhe u nis në atë drejtim. Pas pak, ai u plagos. Ka nderuar jetë në spitalin e UÇK-së në Irzniq/Rznić, ku e çuan pas plagosjes. Familjarët dhe banorët e kthyen trupin e tij në fshat. I kishte tri plagë nga armë zjarri në gjoks. Varrimi i Tahirit u bë gjatë natës në varrezat e fshatit.

Burimet: deklarata A.S, FDH-19715; FHP, *Haški tribunal, Suđenje Slobodanu Miloševiću*, V, 477; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; *Serbian Forces Attack Village of Loxha and Peja*, pasqyra e lajmeve, KIC, 6.07.1998, FDH-34047; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596.

Milorad (Labud) Rajković

(16.01.1957, serb nga Peja/Peç, katër fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Mirko (Miloš) Radunović

(13.10.1962, serb nga Dashinoci/Dašinovac, komuna e Deçanit/Deçani, dy fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Srdan (Jezdimir) Perović

(20.12.1962, serb nga Peja/Peç, i pamartuar, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Dejan (Nikola) Prelević

(29.07.1974, serb nga Peja/Peç, i pamartuar, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Srdani, Mirko dhe Dejan i kanë qenë të punësuar në SPB-në e Pejës/Peç. Miloradi punonte në fabrikën *Zastava* në Pejë/Peç. Ka qenë pjesëtar i forcave rezervë të policisë nga viti 1986. Ditën e hënë, më **6.07.1998**, ata që të katër gjendeshin në patrullë në fshatin **Loxhë/Loda**. Atje kanë rënë në pusi të forcave të UÇK-së. Mirko dhe Dejan i gjetën vdekjen në vend, ndërkaq Srdani dhe Miloradi u zunë peng. Një ditë më vonë, familjarët i kanë varrosur Mirkon dhe Dejanin në varrezat e qytetit të Pejës/Peç. Policia i ka gjetur mbetjet mortore të Srdanit dhe Miloradit më 16.08.1998, kur forcat e UÇK-së u tërhoqën nga Loxha/Loda. Gjendeshin në një kanal, pranë rrugës që çon për në Zllapek/Zlopek. Obduksioni ka konstatuar se Srdani ka vdekur nga pasojat e keqtrajtimit të rëndë fizik, ndërkaq Miloradi nga një plumb të shkrepur në kokë. Srdani dhe Miloradi u varrosën në varrezat e Pejës/Peç më 18.08.1998.

Burimet: deklarata N.R, FDH-29731; deklarata S.M, FDH-8267; Z. Stijović, *Kosmet...*, 110, 111, 169, 180; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10-832; SMIP, *Teroristički...*, III, 934; FHP, *Haški tribunal, Suđenje Slobodanu Miloševiću*, XVIII, 178; FHP, *Haški tribunal, Suđenje Slobodanu Miloševiću*, XVIII, 253, 254; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 52, 55, 57, 58; Gjykata e Qarkut Požarevac, K.66/99 (Rasim Isufaj dhe të tjerë), aktgjykimi, 16.03.2000, FDH-1963; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), EX.298. 36.1,2,3, FDH-30871; *Poginula trojica policajaca, nekoliko ranjenih*, Politika, 7.07.1998, FDH-34244.

Rrustem (Beqir) Bruqi

(28.08.1958, shqiptar nga Isniqi/Istinić, komuna e Deçanit/Deçani, jurist, tre fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Lumni (Musë) Surdulli

(24.01.1969, shqiptar nga Samadrexha/Samadrezha, komuna e Vushtrrisë/Vuçitrn, ushtarak, pjesëtar i UÇK-së)